



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:207749

Datë: 21.01.2020

Numri i dokumentit: 00775237

P.nr.996/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtaren e vetme gjykuese, Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit Z.B me vendbanim në rrugën “.....” në Shtime, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr. 1643-10/19 e datës 16 Shtator 2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Besnik Nuredini dhe të pandehurit Z.B me datë 03 Janar 2020 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 15 Janar 2020, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: Z.B, i lindur me datë, nga i ati H....., e ëma Rr..... e gjinisë L..., me vendbanim në rrugën “..... ” Komuna Shtime, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, vërtetimi i identitetit është bërë në bazë të numrit personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me 05 Gusht 2019, rreth orës 19:00, tek Restorantin....., Komuna Shtime, me dashje e ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit N,Q, në atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve të mëhershme, ku i dëmtuari ka qenë së bashku me shokun E.R dhe posa të njëjtit kanë dal jashtë lokalit, i pandehuri me grushta e shuplaka e ka goditur në pjesën e fytyrës të dëmtuarit.

me të cilin veprim ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve 2, 4, 7, 8, 17, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370 dhe 453 të KPP-së, të pandehurin Z.B

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 400 € /katërqind euro/, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 € /njëzetë euro/ të gjobës së pa paguar, do ti llogaritet me 1/një/ ditë burgimi.

I dëmtuari N.Q me vendbanim ne Shtime Rruga “.....”, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë /euro, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m i

1.Historiku procedurës dhe aktakuza

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e evidentuar si: PP.II.nr.1643-10/19 e datës 16 Shator 2019, ndaj të pandehurit Z.B, për shkak të veprës penale: Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-ës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, duke vepruar në këtë çështje penale sipas nenit 245 të KPPRK-së, caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor fillestar me datë 03 Janar 2020, dhe pas leximit të aktit

akuzues, gjyqtarja u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 të KPRK-së si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 323 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

2. Pranimi i fajësisë nga i pandehuri

I pandehuri Z.B me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale, kërkon falje publike, është hera parë që ndeshet me ligjin, premtion se më nuk do të përsërisë vepra të tilla, duke i propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të ulët.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurori i Shtetit Besnik Nuredini duke shprehur mendimin e sajë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit meqë ky pranim është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pranimin e fajësisë i akuzuari e ka bërë vullnetarisht dhe se një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPK-së si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, ndërsa i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim në pajtim me ligjin.

3. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor fillestar për të gjitha pikat në aktakuza, gjyqtarja e vetme gjykuese për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit dhe mbrojtësit me autorizim të pandehurit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 edhe përkundër paralajmërimit të pandehurit për nenin 246 par. 1 të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- I akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;

- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë: Raporti i Officerit me numër rasti i datës 05 Gusht 2019, deklarata e të dëmtuarit N.Q e datës 05 Gusht 2019 si dhe nga vetë deklarata e të pandehurit e dhënë në Stacionin Policor në Shtime me datë 15 Gusht 2019.
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtarja po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprat penale të të pandehurit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjyqtarja e vetme gjykuese vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi: se tek Restaurant, Komuna Shtime, i njwjt i me dashje e ka përdorur forcën ndaj të dëmtuarit N.Q, në atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve të mëhershme, ku i dëmtuari ka qenë së bashku me shokun E.R dhe posa të njëjtit kanë dal jashtë lokalit, i pandehuri me grushta e shuplaka e ka goditur në pjesën e fytyrës të dëmtuarit, andaj duke marrë parasysh se në veprimet inkriminuese të tij janë përmbushur elementet e veprës penale sulmi, i njëjti është penalisht përgjegjës dhe është shpallur fajtorë për këtë veprë penale.

4.Caktimi i dënimit për të pandehurin

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjyqtarja i vetme gjykuese, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim 69, 70, dhe 71 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, si rrethanë lehtësuese vlerësoi se deri më tani i padënuar me aktgjykim të formës së prerë, pendimin real dhe të sinqertë, kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të

pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, ndërsa me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti në rastin konkretë.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtarja e vetme gjykuese është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, është hera e parë që ndeshet me ligjin si dhe duke vlerësuar se edhe me dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë veprës penale dhe kryrësit, që do të shërbej në parandalimin të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

5. Kërkesa pasurore juridike si dhe shpenzimet procedurale

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pasi që e njëjta nuk është precizuar nga pala e dëmtuar dhe nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërisht.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga arsyet e lartë shënuara u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,

P.nr.996/19 me datë 15 Janar 2020

Gjyqtarja:

Mimoza Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.